

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga dënimi në Shqipëri te atentati në Selanik/ Kush është Gentian Çipi, i burgosuri që i iku policisë grek e
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/12/nga-denimi-ne-shqiperi-te-atentati-ne-selanik-kush-eshte-gentian-cipi-i-burgosuri-qe-i-iku-policise-greke/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 10:47:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 10:42:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d51a852ef379f1c570c6d7a510eaf3268999df3e37ad54b77c3d0dc3b5e25168
TEKSTI	f8e4cbca7a1ef1f6bc5a3eefd4e0c1158c02f16dccef92a0f6c492aa8c1f32e8
PAMJA	f691a4e4398015b4b567ffb960d0cc10420b1f2588422a98ce98facb54bf40d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f07d828ed0de9956568b4f6685509ba3d950935a856ecad16f445cbcae5dc3c7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ec54c06a5f3c7f28099f77edc2da79ff2af36ac317165ec9e0f07ad8a247d7a6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f07d828ed0de9956568b4f6685509ba3d950935a856ecad16f445cbcae5dc3c7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Nga dënimi në Shqipëri te atentati në Selanik/ Kush është Gentian Çipi, i burgosuri që i iku policisë greke

12:42 : 12/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE, RAJONI



Një arratisje e denjë për një skenar filmi ka ndodhur në Greqi teksa një 41-vjeçari shqiptar i identifikuar si Gentian Çipi u arratis mbrëmjen e së premtes nga zona e Spitalit të Përgjithshëm të Serresit, pasi një grup bashkëpunëtorësh të armatosur i zunë pritë automjetit që po e transportonte nga burgu drejt spitalit.

Sipas raportimeve të publikuara gjatë ditës së sotme, ngjarja ndodhi rreth orës 23:30, në ambientet e jashtme të spitalit, pranë repartit psikiatrik.

Në automjet ndodheshin Çipi dhe dy punonjës që e shoqëronin. Në një moment, pranë mjetit u shfaqën dy automjete që ngjanin me makina policie.

Personat që ndodheshin në to iu afruan eskortës dhe, nën kërcënimin e armëve, neutralizuan dy shoqëruesit.

Autorët më pas nxorën Gentian Çipin nga automjeti dhe e ndihmuan të largohej. Sipas informacioneve të raportuara, grupi mori edhe armën e shërbimit të njërit prej punonjësve të burgut, përpara se të largohej me automjetet.

Lexo edhe:

[Arratisja e Gentian Çipit në Greqi, gjendet një prej mjeteve të bashkëpunëtorëve, dyshohet se u aksidentuan](#)

[Ekzekutimi i shqiptarit në Itali/ Ferdinand Hoti tentoi të largohej nga bota e trafikut të drogës](#)

Si u arratis dhe çfarë po heton policia?

Sipas autoriteteve greke arratisja ishte e mirëorganizuar dhe e planifikuar nga bashkëpunëtorë të jashtëm.

Dy automjete të ngjashme me makinat e policisë iu afruan eskortës, personat e armatosur neutralizuan shoqëruesit dhe më pas nxorën Çipin nga automjeti.

TË GJITHA



Nga dënimi në Shqipëri te atentati në Selanik/ Kush është Gentian Çipi, i burgosuri që i iku policisë greke

12:42 : 12/09/2026



Protestë kundër ndërtimit të Muzeut Hebraik në Vlorë, përplasje me policinë (Video)

12:36 : 12/09/2026



E rëndë në Belsh/ Ra në kontakt me energjinë elektrike, humb jetën elektrikisti 32-vjeçar i OSHEE-së (Emri)

12:16 : 12/09/2026



I dënuar me 2 vite burg nga GJKKO për korrupsion, kapet në Sarandë i dehur (Emri)

12:12 : 12/09/2026



Arratisja e Gentian Çipit në Greqi, gjendet një prej mjeteve të bashkëpunëtorëve, dyshohet se u aksidentuan

11:50 : 12/09/2026



Reshjet e shiut shuajnë zjarret në vend, vetëm 1 vatër aktive

11:39 : 12/09/2026



Aksident në Tiranë, urbani përplaslet me një automjet te rruga "Bardhyl"

11:23 : 12/09/2026

Fakti që në njerën prej makinave u gjet një kallashnikov dhe se një tjetër automjet u gjet i djegur ka shtuar dyshimet se grupi kishte përgatitur disa mjete për largimin dhe për humbjen e gjurmëve. Policia greke vijon kërkimet për Çipin dhe bashkëpunëtorët e tij.

Një makinë gjendet e aksidentuar, në të gjendet kallashnikov

Hetimi i policisë greke ka sjellë tashmë edhe detaje të reja. Pranë spitalit, mes kallamishteve, është gjetur një automjet i aksidentuar, i dyshuar se është përdorur nga autorët e arratisjes.

Sipas të dhënave paraprake, gjatë largimit automjeti ka goditur diku dhe një prej personave që ndodheshin në të dyshohet se është plagosur në kokë. Brenda makinës policia ka gjetur një kallashnikov dhe municione, ndërsa po merren mostra për ekzaminim kriminalistik.

Pak më herët, policia kishte gjetur edhe një automjet të djegur plotësisht në Vrasna, në territorin e Bashkisë së Volvit.

Hetuesit po verifikojnë nëse edhe kjo makinë është përdorur në operacionin e arratisjes. Autoritetet po rindërtojnë itinerarin e grupit dhe po kërkojnë si Çipin, ashtu edhe bashkëpunëtorët e tij.

Kush është Gentian Çipi?

Gentian Çipi është 41 vjeç, nga Korça dhe banues në Dishnicë. Sipas raportimeve të sotme, ai ka precedentë penalë si në Shqipëri, ashtu edhe në Greqi.

Në Shqipëri, Çipi rezultoi të jetë dënuar në korrik 2024 me dy vite burgim për veprën penale të “shkatërrimit të pronës me zjarr”, në bashkëpunim dhe në rrethana rënduese. Çështja lidhej me djegien e një automjeti më 24 prill 2023, në lagjen 13, në rrugën “Loni Grazhdani” në Korçë.

Më herët, në janar 2023, emri i tij ishte përfshirë edhe në operacionin “Fijet”, pasi policia kishte evidencuar kamera të vendosura në mënyrë të paligjshme pranë banesës së tij.

Dosja më e rëndë që e lidh Çipin me drejtësinë greke është një tentativë vrasjeje në Selanik.

Sipas policisë greke, më 3 shtator 2024, në zonën e Pylaia-s, pranë një pike ushqimore, u qëllua me armë ndaj një 25-vjeçari grek. I riu u godit nga tre plumba, por mbijetoi. Autoritetet greke dyshuan se personi që hapi zjarr ishte Gentian Çipi.

Pas hetimit, policia greke e identifikoi Çipin dhe në shtator 2025 zhvilloi një operacion për arrestimin e tij dhe të dy personave të tjerë nga Korça, Enea Basholli dhe Kleo Topa. Sipas autoriteteve greke, Çipi konsiderohej drejtues i një grupi të dyshuar për trafik droge dhe veprime të dhunshme kriminale.

Gjatë operacionit të arrestimit, Çipi dhe Topa tentuan t’i shpëtonin policisë, duke mos iu bindur urdhrat për ndalim, duke kryer manovra të rrezikshme dhe duke përplasur një automjet policie. Ata u larguan në këmbë, por u kapën më pas.

Në kontrollet e kryera nga autoritetet greke u sekuestruan:

- një kallashnikov me 30 fishekë;
- tre pistoleta;
- një silenciator;
- rreth 31 kilogramë marijuanë;
- një pasaportë dhe një patentë të falsifikuar;
- 23.350 euro cash;
- celularë dhe tre automjete.

Etiketa: Gentian Çipi greqi arratisje trafik droge

Lajme të lidhura





Arratisja e Gentian Çipit në Greqi, gjendet një prej mjeteve të bashkëpunëtorëve, dyshohet se u aksidentuan

11:50 : 12/09/2026



Ekzekutimi i shqiptarit në Itali/ Ferdinant Hoti tentoi të largohej nga bota e trafikut të drogës

15:58 : 10/09/2026



Trafik droge nga Shqipëria në Itali/ Mbyllet hetimi, kush janë 66 personat e përfshirë – EMRAT

18:02 : 29/08/2026



I kërkuar nga Italia për trafik droge, arrestohet në Durrës 33-vjeçari (Emri)

11:25 : 21/08/2026



Pjesë e një organizate të trafikut të drogës, arrestohet 32-vjeçari në Malësi të Madhe (Emri)

11:18 : 20/08/2026



I shpallur në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Rinas 32-vjeçari

10:00 : 19/08/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

